

VENDIM
Nr.18, datë 10.1.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË FEDERALE TË REPUBLIKËS FEDERALE TË JUGOSLLAVISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SHËNDETËSISË DHE TË SHKENCAVE MJEKËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë, për bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë dhe të shkencave mjekësore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE

MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË FEDERATIVE TË JUGOSLLAVISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SHËNDETËSISË DHE SHKENCAVE MJEKËSORE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria Federative e Republikës Federative të Jugosllavisë (këtej e tutje të quajtura si “Palë Kontraktuese”);

Duke dëshiruar promovimin e bashkëpunimit në fushën e mjekësisë dhe shkencave mjekësore, Kanë rënë dakord për Marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të nxisin dhe zhvillojnë bashkëpunimin mbi bazën e barazisë, reciprocitetit dhe përfitimit reciprok, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Neni 2

Palët Kontraktuese do të zhvillojnë bashkëpunimin në fushat e mëposhtme, të shëndetësisë dhe të shkencave mjekësore:

- 1) parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve jo-ngjitëse (kardiovaskulare, onkologji, sëmundje të mushkërive, diabeti, traumatologji, etj.);
- 2) parandalimi dhe kontrolli epidemiologjiko-sanitar i sëmundjeve ngjitëse dhe atyre parazitale (AIDS, hepatiti viral, gripi, etj.);
- 3) kontrolli, tregtimi dhe cilësia e barnave;
- 4) kontrolli i shitjes së materialeve narkotike dhe të rrezikshëm;
- 5) informacion mbi teknologjinë dhe shëndetin;
- 6) arsimin shëndetësor dhe trajnime pas-universitare;
- 7) shkëmbim informacioni mbi legjislacionin e ri në fushën e Shëndetësisë;
- 8) çështje të tjera për të cilat Palët Kontraktuese do të bien dakord.

Neni 3

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacion në konferenca ndërkombëtare dhe simpoziume, që do të mbahen në vendet e tyre, që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe shkencat mjekësore.

Neni 4

Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

- për Republikën Federative të Jugosllavisë – organizata kompetente federale e ngarkuar me punët e Shëndetësisë,
- për Republikën e Shqipërisë – Ministria e Shëndetësisë.

Me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, do të hartojnë Programet e Bashkëpunimit duke specifikuar format dhe kushtet e bashkëpunimit si edhe kërkesat finciare që rrjedhin prej tyre.

Programet do të hartohen dhe nënshkruhen për një periudhë dy-vjeçare.

Neni 5

Autoritetet kompetente dhe organizatat e Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë revista shëndetësore dhe filma mbi mbrojtjen e shëndetit si dhe materiale të tjera të shkruara, vizuale ose audio-vizuale në fushën e shëndetësisë dhe shkencave mjekësore.

Neni 6

Palët Kontraktuese, në përputhje me interesat reciproke, do të koordinojnë aktivitetet e tyre me OBSH-në (Organizatën Botërore të Shëndetësisë) dhe organizata të tjera ndërkombëtare në fushën e shëndetësisë.

Neni 7

Amendamentet për këtë Marrëveshje mund të bëhen pas aprovimeve të dhëna nga Palët Kontraktuese.

Neni 8

Marrëveshja do të finalizohet për një periudhë të pacaktuar kohe.

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën që kërkesat sipas legjislacioneve respektive, për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, janë plotësuar.

Secila nga palët mund ta denoncojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar Palën tjetër me shkrim, për synimin e saj për denoncimin e Marrëveshjes. Në këtë rast, Marrëveshja do të pushojë së qeni në fuqi brenda 6 muajve nga data e marrjes së njoftimit të fundit.

Firmosur në Beograd më 16 Nëntor 2002 në dy kopje origjinale, në shqip, serbisht dhe anglisht, duke qenë të gjithë tekstet autentike.

Në rast interpretimi të ndryshëm, referimi do t'i bëhet tekstit në anglisht.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

PËR QEVERINË FEDERALE TË
REPUBLIKËS FEDERALE TË
JUGOSLLAVISË